

PROCESVERBAL
nga seanca e 11-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 20.08.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë, ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 11-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Petrushevski, shpjegoi se seancat publike në pajtim me Ligjin janë të dedikuara për arsyetim të mediave, por meqënëse në seancë nuk ka pasur përfaqësues të pranishëm nga ana e transmetuesit, seancën e deklaroi të mbyllur.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.